

KOSOVA 1968-1990

(Shkodran Imeraj, *Kosova 1968-1990*, Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2021, f. 274)

Monografia: “*Kosova 1968-1990*”, është një studim, i cili në thelb pasqyron segmente nga historia politike e Kosovës gjatë periudhës nga viti 1968, kur në Kosovë do të shpërthejnë demonstratat e para pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore e deri më 1990, kur zyrtarisht Kosovës do t’i hiqet elementi konstituiv në kuadër të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, e drejtë kjo e garantuar me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së re të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë më 1974.

I gjithë studimi është i mbështetur në burime të shumta arkivore që gjenden në institucione të ndryshme të Kosovës, si në: Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës (Arkivi i Kosovës), Arkivin e Institutit të Historisë në Prishtinë, nëpër arkivat e disa prej gjykatave të Kosovës, arkivave komunale e ndërkomunale. Një mbështetje e madhe për hartimin e kësaj monografie ka qenë edhe literatura historiografike të cilën e ka konsultuar me shumë kujdes, duke evidentuar arritjet e historiografisë shqiptare si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri. Rëndësi i është kushtuar edhe literaturës së botuar në gjuhën angleze dhe atë serbe. Pjesë e pandashme e kësaj trajtëse padyshim janë edhe të dhënat nga shtypi i kohës.

Kreu i parë, që titullohet: “Kosova në prag dhe gjatë demonstratave të vitit 1968”, është ndarë në 14 nëntituj, ku trajtohen me theks të veçantë Plenumi IV i Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, i cili i zhvilloi punimet më 1 korrik 1966, në Brionë të Kroacisë. Siç mund të mësohet edhe nga trajtimi i kësaj çështjeje, Plenumi IV i Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë apo siç njihet nga historiografia shqiptare, Plenumi i Brionëve, ishte një sqarim hesapësh midis frymës së moderuar komuniste të drejtuar nga Josip Broz Tito dhe nga fryma nacionaliste serbe e drejtuar nga Aleksandër Rankoviqi. Në vazhdim të kreut të parë, një vëmendje e veçantë i është kushtuar themelimit të institucioneve shkencore në Kosovë, si: Institutit Albanologjik të Prishtinës, Institutit të Historisë-Prishtinë, hapjes dhe funksionimit të Universitetit të Prishtinës si dhe themelimit dhe aktivitetit të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Krahas themelimit të universitetit,

instituteve shkencore dhe akademisë, gjatë shtjellimit të temës i është kushtuar rëndësi edhe veprimtarisë botuese të këtyre institucioneve.

Botimet e instituteve shkencore dhe Akademisë së Shkencave, ishin tepër të rëndësishme për shqiptarët e Kosovës e më gjerë, pasi u mbulua një boshllëk i madh i mungesës së literaturës së nevojshme shkencore në gjuhën shqipe. Krijimi i institucioneve shkencore dhe atyre arsimore në Kosovë, pas përfundimit të demonstratave të vitit 1968, ishte një arritje shumë e madhe për shqiptarët, të cilët jetonin në kuadër të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, pasi për herë të parë në këtë territor fillon një jetë e re dhe intelektualët e saj, ata që kishin ambicie për t'u marrë me probleme shkencore, tashmë e kishin mundësinë, ata kishin institutet, universitetin dhe Akademinë e tyre të Shkencave. Në këtë kapitull autori nuk ka trajtuar tema me rëndësi si: *Qëndrimi i Lidhjes Komuniste të Kosovës ndaj demonstrative të vitit 1968; Fillimet e ndryshimeve kushtetuese në Jugosllavi më 1968; Lejimi i flamurit kombëtar, pikëtakimet e para ndërmjet shqiptarëve të Kosovës dhe atyre të Shqipërisë në kontekstin e bashkëpunimit shkencor në janar 1968; Simpoziumin e 500-vjetorit të Skënderbeut në Prishtinë dhe ardhjen e delegacionit të parë zyrtar nga Shqipëria në Kosovë; Aktivitetet politike në Kosovë që ishin thelbësore në artikullimin e kërkesës për Republikën e Kosovës; Qëndrimin e Shqipërisë për demonstratat e vitit 1968, Interesimi i shtetit shqiptar për Kosovën dhe hapja e sektorit të veçantë në kuadër të këtij shteti me emërtimin "Sektori për Kosovën" etj.*

Kreu i dytë, i cili titullohet: "*Kosova element konstituiv i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë*", është i ndarë në 7 nëntituj, ku në mënyrë të veçantë trajtohet statusi politik i Kosovës brenda Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë. Me miratimin e Kushtetutës së re të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë në vitin 1974, republikat si dhe krahinat autonome ishin të obliguara që të hartonin kushtetutat e tyre sipas Kushtetutës së Federatës. Kështu, pas një pune të gjatë, më 27 shkurt 1974, Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, miratoi Kushtetutën e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, e cila është edhe Kushtetuta e parë e Kosovës. Në kuadër të këtij kreu, është trajtuar në mënyrë specifike e gjithë struktura e institucioneve të Kosovës, duke filluar nga Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Kryesia e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Këshilli i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Këshilli Ekzekutiv i Kuvendit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës. Po ashtu një rëndësi e madhe i është kushtuar edhe krijimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, pastaj Gjykatës Supreme, si

dhe Prokurorisë Publike të Krahinës dhe Avokatit Shoqëror Krahinor të Vetëqeverisjes.

Me miratimin e Kushtetutës së Krahinës Socialiste Autonome, Kosova e fitoi statusin e elementit konstituiv në kuadër të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë. Përfaqësuesit e saj, tashmë ishin pothuaj në të gjitha mekanizmat qeverisëse të Federatës. Ky kapitull do të ishte më i plotë po që se tabloja e tematikës nga autori do të plotësohej edhe me pjesë si: *Bashkëpunimi arsimor, shkencor dhe kulturor Kosovë-Shqipëri, 1970-1981*; *Kosova në vorbullën jugosllave, 1970-1981*; *Qëndrimi i Shqipërisë ndaj figurave dhe ngjarjeve politike në Kosovë, 1970-1981*; *Veprimtaria e Lëvizjes Ilegale e Kosovës, 1970-1981* etj.

Kreu i tretë, që titullohet: “Demonstratat e vitit 1981”, është i ndarë në 2 nëntituj, ku trajtohen në mënyrë të veçantë demonstratat e marsit dhe prillit të vitit 1981. Siç dihet, këto demonstrata filluan më 11 mars 1981 në Mensën e Studentëve të Universitetit të Prishtinës. Rrethanat në të cilat shpërthyen këto demonstrata ishin tepër të ndërlikuara. Vdekja e drejtuesit disavjeçar të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, Tito, do të prishte ekuilibrin e forcave në vend.

Si rrjedhim, aty filloi edhe ngritja e ndjenjave nacionale tek popujt e Federatës. Si pasojë e kësaj, shpërthyen edhe demonstratat studentore të pranverës së vitit 1981 në Kosovë. Në kuadër të kreut të tretë, po ashtu një hapësirë e madhe i është dhënë pasqyrimin të demonstratave të vitit 1981 në shtypin e përditshëm në Kosovë. Këtu, duhet veçuar gazeta “Rilindja” në gjuhën shqipe, gazeta “Jedinstvo” në gjuhën serbe, të cilat në masë të madhe ishin të mbushura me artikuj mbi zhvillimet e këtyre demonstratave.

Kreu i katërt, që titullohet: “Heqja e Autonomisë së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës dhe fillimi i ndërtimit të institucioneve të pavarura të Republikës së Kosovës”, është i ndarë në 10 nëntituj. Në këtë syth analizohen ngjarjet politike në Kosovë gjatë periudhës së vitit 1987 deri në dhjetor 1989. Siç dihet gjatë vitit (1987), me ardhjen në krye të Lidhjes së Komunistëve të Serbisë të Sllobodan Milosheviqit, do të fillojë një fushatë e egër kundër shqiptarëve të Kosovës, ku drejtuesit më të lartë serbë do të vihen në krye të ndryshimeve në Kushtetutën e Republikës Socialiste të Serbisë, duke përfshirë edhe Kushtetutën e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës. Një rëndësi e veçantë në kuadër të këtij kreu, i është kushtuar kundërshtimit të shqiptarëve të Kosovës për ndryshimet kushtetuese, apelit të 215 intelektualëve të Kosovës si dhe grevës së minatorëve të Kombinatit “Trepça”, si shprehje e pakënaqësisë së

shqiptarëve të Kosovës për fillimin e ndryshimeve fundamentale të Kushtetutës së vitit 1974.

Në rrethana tepër të komplikua politike, Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, më 23 mars 1989, do t'i hapte rrugën ndryshimeve kushtuese, duke i miratuar këto të fundit me një kundërshtim të një numri të vogël të delegatëve shqiptarë. Kështu, më 28 mars 1989, Kuvendi i Republikës Socialiste të Serbisë do t'i shpallë të miratuara ndryshimet kushtetuese ku hiqet Autonomia e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës. Me këtë rast asaj i hiqen edhe shumë kompetenca në kuadër të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë. Në vazhdim të këtij kreu, trajtohen demonstratat dhe reagimet e shqiptarëve të Kosovës për ndryshimet kushtetuese. Në fund, pasqyrohet fillimi i rezistencës aktive të organizuar të shqiptarëve të Kosovës ku një rëndësi të veçantë i është kushtuar themelimit të lëvizjes gjithëpopullore, Lidhjes Demokratike të Kosovës, në krye të së cilës do të vihet dr. Ibrahim Rugova.

Në vazhdim të këtij kreu janë analizuar fillesat e themelimit të institucioneve të pavarura në Kosovë. Siç dihet, më 2 korrik 1990, Kuvendi i Kosovës, në kushte të jashtëzakonshme, në një mbledhje që i zhvilloi punimet para shkallëve të ndërtesës së Kuvendit të Kosovës, do të miratohej Deklarata Kushtetuese me anë të së cilës u abrogua (anulua) vendimi i 23 shkurtit 1989 i Kuvendit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, për ndryshimet kushtetuese. Më pas po ata delegatë që miratuan Deklaratën Kushtetuese të 2 korrikut 1990, në qytetin jugor të Kosovës, në Kaçanik, më 7 shtator 1990, do të miratonin aktin më të lartë juridik, Kushtetutën e Republikës së Kosovës, apo siç njihet ndryshe, Kushtetuta e Kaçanikut. Me miratimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, u krijuan kushtet bazike për themelimin dhe funksionimin e institucioneve të saj. Po ashtu, në këtë kre është analizuar edhe vendosja e masave të dhunshme nëpër institucionet e Kosovës, përfshirë edhe institucionet shkollore, universitare, shkencore e akademike. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe vrasjes së ushtarëve shqiptarë gjatë kryerjes së shërbimit ushtarak në Armatën e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, në periudhën 1981-1990. Duke prekur këto problematika, autori ka anashkaluar jo pak çështje me rëndësi si: *Qëndrimi i Shqipërisë ndaj demonstratave të vitit 1981 në Kosovë; Qëndrimi i Lidhjes Komuniste të Kosovës më 1981; Diferencimi ideopolitik i intelektualëve shqiptarë të Kosovës; Universiteti i Prishtinës; Lëvizja ilegale atdhetare e Kosovës, 1981-1990; Ndryshimi i plan-programeve në shkollat fillore, të mesme dhe të larta të Kosovës; Memorandumi i Akademisë së Shkencave të Serbisë; Takimi i shkrimtarëve*

të Kosovës dhe të Serbisë, më 1988; Rrënimi i institucioneve arsimore, kulturore dhe shkencore të Kosovës; Helmimi i nxënësve në Kosovë; Pajtimi i gjaqeve; Qëndrimi i Shqipërisë ndaj zhvillimeve politike në Kosovë, 1989-1990 etj.

Libri do të ishte më kuptimplotë po që se vërejtjet e lartcekura dhe sugjerime të tjera do të rrumbullakosnin këtë problematikë me rëndësi për çështjet e zhvillimeve politike, shoqërore të Kosovës, 1968-1990. Libri është mbështetur me dokumente arkivore të Lidhjes Komuniste të Kosovës (1968-1990); të ilegales shqiptare në Kosovë (1968-1990), të Shqipërisë, ku faktohet qëndrimi i këtij shteti (1968-1990), etj. Me këto materiale padyshim studimi do të kishte një rrjedhë më të gjerë dhe më objektive. Dr. Shkodran Imeraj me këtë studim ka kontribuar që historiografia kosovare të begatohet me të dhëna interesante që padyshim janë të vlefshme për opinionin publik dhe shkencor kosovar.

Kosovar BASHA

